

FORMULAR IDENTIFIKIMI I PERSONIT TË EKSPOZUAR POLITIKISHT (PEP)

1. **Person politikisht i ekspozuar** – persona fizikë të huaj apo vendorë, të cilët janë ose kanë qenë të ngarkuar me funksione të larta publike të listuara më poshtë:
2. **Anëtarë të ngushtë të familjes** – nënkupton Bashkëshortë apo ekuivalent me bashkëshortë, Fëmijë dhe bashkëshortët e fëmijëve apo ekuivalent me bashkëshortë, Prindërit e personit të ekspozuar politikisht:
3. **Bashkëpunëtor i ngushtë** – nënkupton çdo person fizik që mund të jetë pronar i përbashkët përfitues të personave juridikë apo marrëveshjeve juridike, ose çfarëdo marrëdhënie e ngushtë biznesi, dhe çdo person fizik i cili është pronar përfitues i personit juridik apo marrëveshjes juridike e cila njihet se është themeluar për përfitime de facto të personit të ekspozuar politikisht:

Shtetit të Republikës së Kosovës:	
1.	Presidenti i Kosovës, këshilltarët politikë dhe shefi i kabinetit të Presidentit;
2.	Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe personat e zgjedhur nga Kuvendi;
3.	Kryeministri, zëvendëskryeministri, ministrat, zëvendësministrat, këshilltarët politikë dhe shefat e kabineteve;
4.	Auditorët në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
5.	Anëtarët e bordeve, administratorët, menaxherët dhe mbikëqyrësit e ndërmarrjeve publike;
6.	Anëtarët e Bordit, guvernatori dhe zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore;
7.	Kryetarët e komunave;
8.	Gjyqtarët e Gjykatës Supreme dhe Kushtetuese;
9.	Ambasadorët, konsujt apo të ngarkuarit me punë;
10.	Zyrtarët e lartë ushtarakë në gradën e gjeneralit dhe më lart;
11.	Zyrtarë të rëndësishëm të subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvend të Kosovës, përfshirë anëtarët e këshillave drejtues të tyre në nivel qendror.

Shtetit të Huaj:	
1.	Kryetarët e shtetit ose kryetarët e qeverisë, ministrat, zëvendësministrat ose asistentët e ministrave, shefat e kabineteve dhe këshilltarët politikë;
2.	Anëtarët e Parlamentit dhe personat e zgjedhur nga Parlamenti ose anëtarët e organeve të ngjashme legjislative;
3.	Anëtarët e zyrës kombëtare të auditimit, të gjykatës së auditorëve;
4.	Anëtarët e bordeve, administratorët, menaxherët dhe mbikëqyrësit e ndërmarrjeve publike;
5.	Anëtarët e bordit, guvernatori dhe zëvendësguvernatori i autoritetit bankar qendror;
6.	Gjyqtarët e gjykatës supreme, të gjykatës kushtetuese ose të një trupi tjetër gjyqësor ose ushtarak të nivelit të lartë gjyqësor, vendimet e të cilave nuk l nënshtrohen ankimit të mëtejshëm, përveç në rrethan të jashtzakonshme;
7.	Ambasadorët, konsujt apo të ngarkuarit me punë;
8.	Zyrtarët e lartë ushtarakë në gradën e gjeneralit dhe më lart;
9.	Zyrtarë të rëndësishëm të subjekteve politike që janë të përfaqësuar në Parlament, përfshirë anëtarë të këshillave të tyre drejtuese;
10.	Persona të ngarkuara me funksione të rëndësishme në organizata ndërkombëtare, si: drejtorë, zëvendësdrejtorë dhe anëtarë të këshillave apo funksione ekuivalente në organizata ndërkombëtare.

Shtojca Nr.1-B

Anëtarë i ngushtë i familjes së personit të renditur në listën më sipër		
1.	Bashkëshorti/e apo çdo person që konsiderohet si ekuivalent me bashkëshortin	
2.	Fëmijë dhe bashkëshortët e fëmijëve apo personat që konsiderohet si ekuivalent me bashkëshortin	
3.	Prindërit	